



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1008/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), paraqitur kundër Albulena Haxhiu deputete në Kuvendin e Kosovës, nga Lëvizja Vetëvendosja (LVV), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore gjatë ditës së zgjedhjeve, në raundin e dytë të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), në Prishtinë, kështu që Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 250 (dyqindpesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 02.12.2013 ka pranuar një ankesë, nga BIRN, në Prishtinë, në të cilën theksohet se me datën 01 dhjetor 2013, në cilësinë e vëzhguesit kam monitoruar respektimin e heshtjes zgjedhore nga partitë politike në mediat sociale. Aty kam vërejtur që Albulena Haxhiu deputete e Lëvizjes Vetëvendosje, ditën e zgjedhjeve, më 1 dhjetor ka shkelur ligjin duke bërë fushatë përmes një postimi në rrjetin social të Facebook-ut, duke u bërë thirrje qytetarëve që të dalin e votojnë LVV. Sipas parashtruesit të ankesës, përmes këtij postimi ka bërë fushatë të hapur dhe ky veprim bie ndesh me nenin 36 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur ankesës si provë një faqe të Facebook-ut.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi LVV më datën 03.12.2013, për ankesën që është bërë ndaj saj dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 04.12.2013 deri në ora 10:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga LVV, në të cilën theksohet se postimi i tekstit i bashkëlidhur me ankesën e parashtrueses, nuk mund të provojnë autorësinë e postimit, si dhe pronësinë ndaj llogarisë në rrjetin Facebook të deputetes së LVV. Natyra e funksionimit të rrjetit social Facebook, nuk do të duhej të interpretohej si hapësirë publike, e cila duhet të njehet me thirrje publike, siç rëndomtë ka për qëllim fushata elektorale. Mënyra e komunikimit në këtë rrjet social është i kushtëzuar me konektimin e këtij rrjeti sipas vullnetit të lirë të palëve, për dallim kur një mesazh i dërguar në mënyrë publike i dedikohet një numri të pacaktuar të njerëzve në këtë rrjet social, publikimi është i kontrollueshëm, pra privatësia në këtë rrjet është e kontrollueshme, thuhet në përgjigjen në ankesë nga LVV.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga foto e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihen qartë përmbajtja tekstuale e postimit në rrjetin social Facebook, me datë 1 Dhjetor 2013, i bërë nga Albulena Haxhiu deputete e Kuvendit të Kosovës nga LVV, “duke falënderuar ata të cilët kanë kryer obligimin, ndërsa për ata që ende nuk kanë votuar, bën thirrje që të dalin të votojnë për ndryshim dhe për kandidatin për kryetar të Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti”, nga LVV në ditën e zgjedhjeve me 1 Dhjetor 2013, i cili veprim është në kundërshtim me nenin 7.1 pika b), e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013, dhe me nenin 36.1 pika b) të LZP-së, e cila përcakton se : Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet secili nga veprimet si bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Prandaj PZAP, duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e Albulena Haxhiu deputete e Kuvendit të Kosovës nga LVV, është shkelur neni 7 paragrafi 1 pika “b” të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, pasi që personi në fjalë ka thyer heshtjen zgjedhore duke bërë fushatë zgjedhore duke postuar në rrjetin social Facebook, përmbajtje tekstuale me të cilën bën thirrje për ndryshim dhe votim të kandidatit Shpend Ahmeti për kryetar të Komunës së Prishtinës, në ditën e zgjedhjes me datë 01.12.2013, për Raundin e dytë në Zgjedhjet Lokale, PZAP, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa në Prishtinë

Anr.1008/2013 më datën 04.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*